



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 962/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesues, Kymete Kicaj dhe Adnan Konushevcu anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit, Muhamet Kurtaj nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Komunën e Drenasit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të datës 03.11.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.962/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit, Muhamet Kurtaj, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Drenas, kundër vendimit Nr.2948/2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për Kuvendin Komunal, për shpalljen e rezultatit përfundimtar, me të cilën ka kërkuar që të rinumërohen votat në Qendrat e Votimit 0327E, 0321E, 0317E, 320E, 0323E, 0307E.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin me datën 04.11.2021 nga anëtari për Kuvend Komunal në Komunën e Drenasit, Muhamet Kurtaj nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Komunën e Drenasit, me të cilën pretendon se në Qendrat e Votimit 0327E, 0321E, 0317E, 320E, 0323E, 0307E ka mungesë të votave sepse numri i votave të shpallura nga KQZ-ja nuk përputhen me numrin e votuesve të cilët e kanë votuar, ku numri i votuesve është kryesisht më i madh të cilët janë familjar dhe miq të tij e të cilët, siç theksohet në apel janë të gatshëm të dëshmojnë.

Andaj përmes apelit ka kërkuar që të bëhet rinumërimi në Qendrat e Votimit të cekura në apel

PZAP-i, pasi që shqyrtoi apelin, vlerësoi se:

Apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i apelit kërkon që të rinumërohen kutitë në Qendrat Votuese 0327E, 0321E, 0317E, 320E, 0323E, 0307E, në Komunën e Drenasit. Mirëpo, pretendimet në apel me asnjë provë bindëse nuk i ka dëshmuar se në cilat vendvotime janë bërë parregullsi, ashtu siç pretendon, por vetëm i potencon numrat e Qendrave të Votimit të cekura në apel duke theksuar se i mungojnë votat e

familjaëve dhe nuk ka përputhje me votat e rezultatit të shpallur nga KQZ, duke mos treguar se sa vota mendon se i mungojnë, prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, apelin e parashtruar e konsideron si të përgjithshëm dhe të pa bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Prandaj, PZAP-i, konstatoi se pretendimet në apel janë të pabazuara ngase parashtruesi i apelit nuk ka specifikuar asnjë vendvotim, pasi që vendvotimet në të cilat zhvillohet votimi janë të përcaktuara me numra përkatës, e për të cilën pala ankuese nuk i ka potencuar edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e apelit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.962/2021 më datë 07.11.2021



Kryesues i Panelit
Zyheri Haziri

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.